

# community

The New Apostolic Church around the world

03/2020AI

## Kurajo! Jeta vazhdon

Editoriali  
Kini besim

Shërbesa fetare  
Zoti bën gjëra të mëdha  
me ne

Doktrina kishtare  
Veproni sipas Shkrimit

New Apostolic Church  
International



## ■ Editoriali

- 3 Në gëzim e fatkeqësi:  
Kini besim!

## ■ Shërbesa fetare

- 4 Perëndia bën gjëra të mëdha  
për ne!

## ■ Këndi i fëmijëve

- 10 Ruajtësi i thesarit nga Etiopia  
12 Për vizitë tek Anja nga Sankt  
Petersburg-u (Rusi)

## ■ Doktrina

- 14 Teoria dhe jeta– të veprosh  
sipas Shkrimit

## ■ Global News

- 18 Apostuli kryesor:  
Kurajo – jeta vazhdon

# Në gëzim e fatkeqësi: Kini besim!

Të dashur motra e vëllezër,

në situata të vështira, kur ne ndodhemi para shumë problemeve të pazgjidshme, njeriu kërkon e thërret me forcë Perëndinë: „Ndhimona, o Zot!“ – kjo është lutja në kohë të pasigurt.

Unë kujtoj këtu një tekst biblik që është shumë domethënës: "Zoti do të luftojë për ju dhe ju do të heshtni", thotë Eksodi 24,14. Në atë kohë bëhej fjalë për shmangien që iu bë banorëve të Izraelit, të cilët duhet të kalonin nëpër shkretëtirë: përpara tij shtriheshin pengesa pothuajse të pakapërcyeshme, prapa tij, ushtria egjiptiane e Faraonit të zemëruar. Izraelitët u frikësuan dhe i thirrën Perëndisë. Moisiu u tha atyre se çfarë të bënin: «Ki besim te Zoti, rri i qetë! Nëse ai është në anën tonë, asgjë nuk mund të na ndodhë.» Dhe ne mësojmë nga kjo histori, se Zoti me të vërtetë ka ndërhyrë në një mënyrë të papritur dhe efektive dhe ka shpëtuar popullin e tij

Edhe ne mund të përballemi me situata të vështira. Atëherë Fryma e Shenjtë na thërret të mos frikësohemi apo madje as ta fajësojmë Perëndinë për mjerimin tonë. Përkundrazi, ai na kujton se Zoti na shpëton: Së shpejti ai do të na shpëtojë në një mënyrë të pashembullt, duke dërguar Birin e tij për të na marrë të gjithëve. Jezusi dhe apostujt e tij do të kujdesen që nusja e tij të jetë e gatshme për kthimin e tij.



Foto: NAK International

Prandaj: le të heshtim, të qëndrojmë të qetë në tundim, t'i besojmë Zotit dhe të përgatitemi në lutje për momentin e madh të rrëmbimit tonë.

Përherë dhe vazhdimisht ne përjetojmë kohëra kur kemi qenë mirë. Atëherë ne vijmë përpara Zotit, e adhurojmë dhe e lavdërojmë atë, sepse e dimë se i falemi mirësisë dhe hirit të tij. Ne gëzojmë gëzimin dhe lumturinë që Zoti na jep. Dhe madje edhe në momente kaq të mira të jetës sonë ne duhet të lutemi për kthimin e Krishtit dhe të mos harrojmë se Zoti dëshiron të na japë shumë gjëra të bukura: bashkimin e përjetshëm me të!

Juaji Jean-Luc Schneider



# Zoti bën gjëra të mëdha ndaj nesh!

Gjatë udhëtimit të tij për në Azinë Juglindore në tetor/nëntor 2019-tës, apostuli kryesor Schneider mbajti tre shërbesa fetare si dhe drejtoi disa takime. Më 27.10.2019 ai u bashkua me motra e vëllezër në Kuala Lumpur (Malajzi) për një shërbesë fetare.



Foto: NAK Azia Juglindore

Psalmi 126,3.4

*Zoti ka bërë gjëra të mëdha ndaj nesh; ne jemi të lumtur. O Zot, ktheji mbrasht të burgosurit tanë, ashtu siç kthen përrojtë përsëri nëpër vëndet jugore.*

Motra e vëllezër të mi të dashur, i jam shumë mirënjohës Atit tonë qiellor që kam mundësinë të jem në mesin tuaj. Kjo më ndihmon të shoh sesa i pasur jam, pasi edhe këtu në Mailazi kam qaq shumë motra e vëllezër të besimit.

Kjo ditë më jep mundësinë, të shpreh mirënjohjen dhe respektin tim ndaj jush. Kam respekt të madh për mënyrën sesi ju, ndonjëherë në rrethana të vështira, e jetoni besimin tuaj. Kam respekt të madh përpara shërbimit tuaj, sakrificës suaj dhe dashurisë suaj ndaj Zotit. Kjo nuk është vetëm një frazë e sjellshme, por e mendoj me të vërtetë kështu. Për mua është gjithmonë mirë të takoj motra e vëllezër, pasi mësoj shumë prej tyre. Faleminderit që jeni kështu siç jeni!

Tani dëgjuam një fjalë prej Psalmit 126, i cili është një prej psalmeve më të njohur, pavarësisht faktit se është përkthyer

ndryshe. Në versionin anglisht e frëngjisht del qartë se psalmisti flet për kohën e çlirimit nga robëria babilonase. Teksti gjerman flet për të ardhmen, por që në përmbajtje bëhet fjalë për të njëjtën gjë: Fjalët i referohen kohës së mërgimit. Për shumë vjet me rradhë populli hebre jetonte në syrgjynosje në Babel, derisa Perëndia i dhuroi përsëri lirinë dhe u mundësoi kthimin për në Jeruzalem.

Si fillim u kthye vetëm një pjesë për në Jeruzalem. Natyrisht që njerëzit ishin të lumtur dhe lavdëronin Perëndinë që bëri gjëra kaq të mëdha ndaj tyre dhe i çliroi nga armiqtë e tyre. Këtë madje e dalluan edhe të tjerë, popujt fqinj që gjithashtu thonin: „Zoti ka bërë gjëra të mëdha ndaj tyre“ (Ps 126,2). Kjo është historia.

Por le të shohim tani mbi veten dhe kohën që jetojmë. Edhe ne kemi arsye për të thenë: „Zoti ka bërë gjëra të mëdha ndaj nesh!“ Ai ka bërë gjëra të mëdha ndaj nesh përmes Jezu Krishtit. Biri i Perëndisë e la në qiell lavdinë dhe erdhi në tokë. Ai mori mbi veten të bëhej njeri dhe të jetonte si qenie njerëzore midis njerëzve. Ai e mposhti vdekjen. Askush tjetër nuk mund ta bënte këtë gjë. Kështu ai na çliroi prej së keqes. Një fitore e pakrahasueshme! Askush nuk do mund ta fitonte atë. Ai ishte i vetmi që ishte në

gjëndje ta bënte. Ai e arriti për ne fitoren mbi të keqen. Nuk e kishte të domosdoshme ta bënte për veten, ai e bëri për ne. Ai sakrifikoji jetën e tij për ne. Dëshmia më e madhe e dashurisë që mund të mendohej. Jezusi thoshte: „Askush nuk ka dashuri më të madhe se ajo, e dhënies së jetës së tij për miqtë e tij, ju jeni miqtë e mi“ (Gjo 15,13.14).

## *Në çdo shërbesë fetare Perëndia bën gjëra të mëdha për ne: Ai na fal mëkatet.*

„Perëndia ka bërë gjëra të mëdha tek ne!“ Ai themeloi kishën e tij dhe dërgoi apostujt e tij. Një vepër për të gjithë njerëzit. Nëse ne tanimë shohim mbi veten këtu në këtë pjesë të botës, atëherë mund të themi: Ai u përkujdes për atë, që besimi i krishterë të

zinte rrënjë shekuj më parë edhe në këtë kontinent. Këtë ju e dini me siguri më mirë se unë. Gjërat e mëdha që ai ka bërë! Ai u kujdes që besimi të mbetet ndër shekuj deri më sot. Për mua kjo është një mrekulli! Perëndia ka bërë gjëra të mëdha në mënyrë që mund të jemi të krishterë në këtë vend sot. Më vonë ai dërgoi apostujt në këtë vend. Kështu ne mund të bëheshim fëmijë të Perëndisë, u bëmë të krishterë apostolik të rinj. Zoti ka bërë gjëra të mëdha ndaj nesh. Mendoni për të gjitha ato që ai ka bërë tashmë në jetën tonë. Sa herë na ka ndihmuar në jetën tonë të përditshme dhe ne mund të themi: „Këtë e bëri Zoti. Ai ndërhyri në jetën time dhe i zgjidhi problemet e mia.“ Me të vërtetë, ai ka bërë gjëra të mëdha ndaj nesh!







Ai na dhuroi jetën e tij në Rilindjen prej Ujit e Shpirtit. Një mrekulli e madhe!

Në çdo shërbesë fetare ai bën gjëra të mëdha ndaj nesh. Ai na fal mëkatet. Askush nuk është në gjëndje ta bëjë këtë. Ai na lan mëkatin tonë. Askush nuk mund ta bëjë këtë. Vetëm ai e ka fuqinë për këtë. Ai mund të thotë: Faji yt është larë, ai nuk ekziston më. Ai bën gjëra të mëdha ndaj nesh.

Ai na ndryshon. Ai na formon sipas shëmbëlltyrës së Jezu Krishtit. Një mrekulli e shndërrimit hyjnor! Ne mëkatarët e varfër, njerëz të papërsosur, formohemi pak nga pak sipas imazhit të Jezu Krishtit. Perëndia bën gjëra të mëdha për ne dhe ai e bën këtë në mënyrë të mrekullueshme. Ai mund ta përdorte fuqinë dhe dhunën e tij për këtë por ai nuk e bën. Ai krijon me dashuri dhe durim. Ai krijon një ndryshim kaq të madh në shpirtin tonë dhe këtë vetëm përmes dashurisë, përmes mëshirës së tij dhe me durim. Ai kërkon të bëjë gjëra të mëdha me ne. Ai dëshiron ta festojë bashkë me ne Dasmën në qiell. Të ketë bashkim të përjetshëm me ne. Ta ndërtojë Mbretërinë e paqes në tokë me ne. Sepse ai synon t'ua dhurojë të gjithë njerëzve shpëtimin, si në tokë ashtu edhe në botën e përtejme. Me ne, Priftërinë mbretërore, ai dëshiron të bëjë një punë shpëtuese ndaj njerëzve.

Shihni çfarë gjërash të mëdha bën ai për ne, ndaj nesh dhe bashkë me ne! E gjithë kjo është e madhe pasi ne nuk ishim në gjëndje për këtë. Vetëm Perëndia mund ta bëjë këtë – gjëra të mëdha që shtrihen jashtë imagjinatës sonë, edhe jashtë pritshmërive tona. Ne akoma nuk mundemi ta përfytyrojmë atë që ai do të na japë. Sa shumë do të gëzojmë!

*Të mendojmë për atë çfarë ai bën  
ndaj nesh dhe akoma do të bëjë!  
Le të mbetemi mirënjohës!*

Kjo është kaq e madhe pasi ne nuk e kemi merituar. Askush nuk mund ta meritojë.

Askush nuk është në gjëndje ta përshkruajë atë që Perëndia bën e që ka bërë tashmë ndaj nesh. Dhe ky është një problem për njeriun sot. Ne jemi të zënë me kaq shumë gjëra, sa lind rreziku të mos e perceptojmë më këtë gjë të madhe që Perëndia bën për ne.

Më lejoni të shprehem kështu: djalli na ka zënë me punë në atë mënyrë, sa që nuk mendojmë më fare për gjërat e mëdha që Perëndia bën ndaj nesh. Ne duhet të mendojmë për shumë gjëra të tjera, të bëjmë aq shumë, t'ju përcjellim aq shumë të tjerëve, të lexojmë aq shumë ...

Mendoj se e kuptoni çfarë dua të them. Ky është një rrezik! Ne harrojmë se çfarë ka bërë Perëndia për ne e si pasojë nuk kemi më asnjë mik. Ne madje fillojmë të ankojemi. Nuk jemi më të lumtur dhe jemi po në gjëndjen e popullit të Izraelit.

Në Egjipt izraelitët ishin të skllavëruar dhe Perëndia i çliroi ata prej kësaj skllavërie. Ai ndau detin dhe i ndihmoi kështu drejt lirisë. Kjo tingëllon e pabesueshme por është e vërteta.



Duheshin vetëm disa ditë dhe ata kishin harruar gjithshka e filluan të ankoheshin: „Uji është i hidhur! Në Egjipt kishim mjaftueshëm për të ngrënë, kurse këtu nuk ka asgjë!“, kishin kaluar veçse disa ditë që kur ishin liruar prej skllavërie dhe tashmë po ankoheshin.

Tani mos thoni: „Ah ky populli i Izraelit sa e pamundur!“, pasi ne veprojmë po kështu! – Mjaft u ankove! Kujtohu për gjërat e mëdha që Zoti ka bërë ndaj teje, mendo për atë që ai bën dhe do të bëjë tek ti! Le të mbesim mirënjohës dhe të gëzueshëm!

Në psalm thuhet se ndër popuj do të thuhet: „Zoti bëri gjëra të mëdha ndaj tyre!“ (Ps 126,2).

Por çfarë thonë fqinjët tanë rreth nesh? A thonë ata: „Zoti ka bërë gjëra të mëdha ndaj tyre?“ Mendoj se këtë e dëgjojmë rrallë. Më shpesh njeriu dëgjon zëra krejtësisht ndryshe: „Ku është pra Perëndia yt?“ Këtë këngë e kemi dëgjuar vazhdimisht në histori. Mendoni për Jezusin në kryq. Po këtë dëgjonte edhe ai: „Ai ndihmoi të tjerë dhe nuk mund të ndihmojë veten. Krishti, mbreti i Izraelit, të zbresi tani prej kryqi që ne të shohim e të besojmë“ (Mk 15,31.32). Dhe ata u tallën me të. Por kur ai vdiq, një kapiten romak që qëndronte pranë tha: „Me të vërtetë, ky njeri paska qenë

Biri i Perëndisë!“ (Mk 15,39). Ky njeri pa sesi vdiq Jezusi. Ai pa sesi Jezusi reagoi dhe dëgjoji ato që ai tha. Kjo e solli atë në bindjen: Ky njeri paska qenë me të vërtetë Biri i Perëndisë!

Motra e vëllezër, mjaft shpesh dëgjon hapur ose fshehur vërejtjen: „Ku është pra tani Perëndia yt?“ Mos lejoni të impresionoheni prej kësaj apo të dekurajoheni. Mendoni për gjënë e madhe që Perëndia ka bërë ndaj jush dhe akoma bën, dhe qëndroni besnik!

Ne të gjithë kemi sprovat tona, kundërshtimet, tundimet tona, sido që ta përcaktojmë këtë. Dhe më pas njerëzit thonë: „Ku është tani Perëndia? Ti vuan dhe ai nuk ndihmon, ti po kalon kohë të vështira, ku është pra Perëndia yt?“ Ju nuk keni pse t'i përgjigjeni kësaj. Qëndroni besnikë, kini besim në Perëndinë, ruajeni paqen në zemrën tuaj. Kur njerëzit të shohin se ne nuk dorëzohemi dhe megjithatë i besojmë Perëndisë, që prapëseprapë mbajmë paqe në zemër dhe nuk lejojmë që të na e marrin besimin që: Ati im do të kujdeset për mua, unë mbështetem tek ai!, atëherë pas një farë kohe, ata do të shohin: „Perëndia duhet të ketë bërë gjëra të mëdha ndaj tyre, vetëm shikojini ata: Pavarësisht të gjitha atyre që kanë përjetuar, ata qëndrojnë besnikë në besim, madje edhe në vuajtje ata kanë paqe në shpirt.“



Ndihmës apostuli i distriktit David Devaraj  
(Indi)



Apostuli i distriktit Peter Schulte  
(Paqësori Perëndimor)

Kjo nuk është një teori, kjo mund të përjetohet. Nuk është e pazakontë të dëgjosh: „Në fakt është e pamundur të jesh kaq i qetë dhe i sigurt, kur je në rrethana të tilla, tek ai Perëndia do të ketë bërë diçka të veçantë.“ Në sprova ne mbetemi plot besim dhe bindje, pasi e dimë se Perëndia ka bërë, bën dhe do të bëjë gjëra të mëdha ndaj nesh.

Ne i shërbejmë me forcat tona më të mira Perëndisë, sjellim sakrificë, dhe po këtu dëgjojmë po të njëjtën gjë: „Ku është pra tani Perëndia yt? Ky është shpërblimi për punën tënde, për sakrificën tënde? Ishte krejt e kotë, nuk do të të shpërblehet, ti ke harxhuar fuqinë tënde.“

Lërimi të flasin dhe mos lejoni të dekurajoheni! Lidhur me pyetjen „Ku është tani Perëndia yt?“ nuk kemi pse t'i përgjigjemi. Ne qendrojmë besnikë. Ne gjithashtu vazhdojmë t'i shërbejmë Perëndisë, pasi nuk presim asnjë shpërblim për këtë. Ne nuk sjellim sakrificë për t'u bërë të pasur. Ne i shërbejmë Perëndisë nga dashuria. Ne i sjellim atij sakrificë nga mirënjohja për atë që na ka dhënë.

Unë nuk kam arsye të heq dorë së shërbyeri dhe sakrifikuari. Unë e dua atë, pasi ai më desh i pari. Çfardo që të ndodhë, unë kam gjithmonë arsye t'i shërbej Perëndisë dhe t'i sjell me besnikëri atij sakrificat e mija.

„Zoti ka bërë gjëra të mëdha ndaj tyre“ – pasi ata ende janë të motivuar t'i shërbejnë dhe t'i sjellin sakrificë atij.

Njerëzit shohin edhe bashkësitë tona dhe vënë re – meqë ra fjala ne po ashtu nuk mbyllim sytë nga kjo, – që aty

ndodhin gjëra të cilat nuk duhet të ndodhnin. Ne të gjithë jemi njerëz jo të përsosur dhe si rezultat janë pikërisht këto ndodhi. Dhe përsëri njeriu dëgjon këta zëra: „Ku është Perëndia? Shiko se si sillen ata që dëshirojnë të jenë fëmijë të Perëndisë. Kjo qenka më keq se diku tjetër, e pastaj thonë Krishti qëndron në mes të tyre – qesharake!“

Lërimi të flasin. Ne mbetemi besnikë, ne falim njëri-tjetrin dhe ne mbetemi të lidhur me Perëndinë. Me forcën që marrim nga Jezu Krishti dhe me ndihmën e mëshirës së tij, ne mund të kapërcejmë diferencat, të falim njëri-tjetrin, të pajtohemi dhe të përballojmë të gjitha vështirësitë që mund të krijohen në një bashkësi. Pas një farë kohe, njerëzit duhet të vënë re se: „Me këtë shoqëri është diçka e veçantë. Diku tjetër do të kishte ndodhur ndonjë shpërthim, aty gjithshka do të ishte prishur. Por këta qendrojnë së bashku, ata falin njëri-tjetrin. Kjo është krejtësisht e pazakontë.“

Të dashur motra e vëllezër, ne nuk mund të pengojmë më që njerëzit të thonë: „Ku është pra Perëndia juaj?“, por pasi njohëm atë që Perëndia bën tek ne, ne mbetemi besnikë dhe i besojmë atij edhe në marrëdhënie të vështira. Ne nuk luajmë prej këtu: Ne i shërbejmë Zotit, sepse ai na do dhe ne e duam atë. Çfarëdo që të ndodhë, ne falim njëri-tjetrin dhe mbetemi një në Krisht. Kjo është shenja e asaj që Zoti është bashkë me ne.

Në fjalën tonë thuhet më tej: „O Zot ktheji të burgosurit tanë, ashtu siç sjell përrojtë nëpër vëndet jugore.“ Judenjtë, të cilët u kthyhen prej Babilonisë për në Jeruzalem, nuk kishin harruar se kishin mbetur akoma edhe disa të tjerë





dhe ata donin që Perëndia t'u jepte atë që iu kishte dhënë atyre.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se Perëndia ka bërë gjëra të mëdha tek ne dhe dëshirojmë që ai të bëjë gjëra të mëdha edhe tek të tjerët. Ne nuk mendojmë: „Ne do të shpëtohemi, ne do të bekohemi dhe e kemi merituar këtë.“ Ne dëshirojmë që të gjithë shpirtrat, qoftë këtu apo në botën e përtejme, të kenë pjesë prej asaj që na u dhurua edhe neve.

Të dielën e ardhshme do të festojmë shërbesën fetare për shpirtrat e të larguarve nga kjo jetë. Ne lutemi për shpirtrat e botës së përtejme: „O Zot, bëj gjëra të mëdha ndaj tyre ashtu siç bëre ndaj nesh! Lëri edhe ata të dinë sa i madh që je!“

Në përkthime të tjera të këtij rreshti thuhet: „Ktheje o Zot fatin tonë“, dhe, edhe ky përkthim është goxha i gjetur.

Kur Judenjtë arritën për në Jeruzalem, ata ishin përsëri në vendlindjen e tyre, por atyre iu bë e qartë se kishte ende shumë për të bërë dhe se probleme të mëdha u qëndronin përpara. Prandaj edhe kjo kërkesë e dyfishtë: ktheji të tjerët përsëri dhe ndryshoje fatin tonë. Kjo është gjithashtu edhe lutja jonë. Ne jemi të ndërgjegjshëm për veprat e mëdha që Perëndia ka bërë ndaj nesh, por dimë gjithashtu se nuk jemi ende krejtësisht të shpëtuar. Për këtë arsye lutemi: „O Zot, dërgoje Birin tënd, shpëtona, ktheje fatin tonë, na lejo të kemi mundësinë të hyjmë në Mbretërinë tënde.“ Ky është dhe mbetet qëllimi ynë.

Të dashur motra e vëllezër, mos e lini pas dore të lutemi për kthimin e Jezu Krishtit! Sigurisht që na lejohet të dalim

para Atit tonë qiellor me lutje, me të gjithë shqetësimet dhe dëshirat tona, por dëshira jonë më e madhe është të jemi në përjetësi tek Zoti. Kjo duhet të ishte kërkesa jonë e parë në lutjet tona të përditshme.

Këtu në fjalë thuhet: „... ashtu siç kthen përsëri përrojtë në vendet jugore“. Kjo i referohet klimës në Izrael. Aty është nxehtë dhe thatë e në zonat e shkretëtirës nuk ekziston ujë. Por kur nis të bjerë shi, pas disa orësh krijohen përrejt e lumenj ku më parë nuk ekzistonte asgjë. Ky fenomen aludohet këtu: Aty ku më parë ishte shkretëtirë, thjeshtë asgjë, krijohen përrejt, krijohet jetë.

Kjo është figurë e bukur për Rikthimin e Krishtit. Mund të thuhet se më parë nuk shohim asgjë, por brënda një kohe shumë të shkurtër, për një çast, Perëndia ndryshon gjithshka. Tani shohim një bashkësi me papërsosmëri njerëzore dhe mëkatore. Por Zoti do të vijë dhe papritmas bashkësia nuse e Krishtit do të bëhet e dukshme dhe ne do të shohim lavdinë e Kishës së Krishtit. Kjo është mrekullia e madhe që Perëndia do të bëjë te ne, në mesin tonë. Ende duket krejtësisht e pamundur.

Shpesh, kur unë jam bashkë me fëmijë, më bëjnë pyetjen: „Apostul kryesor, si do të jetë kur Zoti Jezus të vijë përsëri?“, dhe më duhet t'ju them: „Nuk e di, këtë nuk mund t'ua shpjegoj, por kam besim tek Perëndia. Për atë, asgjë nuk është e pamundur. Askush nuk mund ta shpjegojë, askush nuk mund ta kuptojë, por ai do ta bëjë këtë. Dhe ai ka vendosur që unë të jem pjesë e kësaj, si edhe ti. Ne të gjithë duhet të jemi pjesë e kësaj ngjarjeje.“

Perëndia ka bërë gjëra të mëdha ndaj nesh dhe ai do të bëjë për të gjithë ata që mbeten besnikë deri në fund dhe ne do të mbetemi besnikë.

## MENDIME KYÇE


**Ne lavdërojmë Perëndinë për mirësitë e tija. Ne i dëshmojmë ato duke treguar besim në sprova, duke i shërbyer pa u lodhur Perëndisë dhe duke këmbëngulur në dashurinë vëllazërore. Ne i lutemi Perëndisë që të bëjë të mira edhe për të tjerët dhe të na çojë të gjithëve drejt lavdisë së tij.**

## RUAJTËSI I THESARIT NGA ETIOPIA

SIPAS VEP TË APOST 8,26-40

*Filipi është një nga shtatë diakonët, i cili u zgjodh të përkujdesej për vejushat që flisnin greqisht. Por bashkësia në Jeruzalem persekutohet dhe shpërndahet. Filipi shkon në Samari. Atje ai u flet njerëzve për Jezusin, Krishtin.*

Një engjëll i afrohet Filipit dhe i thotë: „Çohu dhe shko drejt jugut, në rrugën që nga Jeruzalemi zbret në Gaza!“ Filipi u ngrit dhe u nis. Mbas pak ai shikon në largësi një karrocë. Njeriu që kish hipur mbi të vinte nga një rrugë e gjatë. Ai vinte nga Etiopia dhe ishte një zyrtar i lartë i oborrit mbretëror – ai administronte thesarin e mbretëreshës Kandake. Ai kishte qenë në tempullin në Jeruzalem dhe po kthehej për në shtëpi. I hipur mbi karrocë lexonte me zë të lartë pjesë nga Shkrimi. Dhe Fryma e Shenjtë i tha Filipit: „Arrije atë karrocë!“





Filipi iu turr afër dhe dëgjoi që ai po lexonte profetin Isaija. Filipi e pyeti atë: „A e kupton atë që lexon?“

Ruajtësi i thesarit i përgjigjet: „E si do të mundja, po s’pata një që të më udhëzojë?“ Pastaj iu lut Filipit që të hipë dhe të ulet pranë tij.

Filipi i shpjegoi ruajtësit të thesarit, që Isaija flet për Jezusin. Filipi i thotë atij se çfarë kishte bërë Jezusi për njerëzimin. Ruajtësi i thesarit dëgjonte me vëmendje.

Dhe ndërsa po vazhdonin

rrugën arritën në një vend me ujë. Ruajtësi i thesarit tha: „Ja uji! Çfarë më pengon të pagëzohem?“

Ai e ndaloi karrocën dhe të dy u futën në ujë. Filipi e pagëzoi ruajtësin e thesarit.

Kur dolën nga uji, Fryma e Zotit e rrëmbeu Filipin dhe ruajtësi i thesarit nuk e pa më; por e vazhdoi rrugën e tij për në atdhe me plot gëzim.





## PËR VIZITË TEK ANJA NGA SANKT PETERSBURG-U (RUSI)

Përshëndetje! Unë quhem Anja dhe jam 14 vjeçe.

Këtu shikoni familjen time: Babai im quhet Aleksander, Mamaja ime Oxana, dhe unë kam edhe një vëlla më të vogël- quhet Artjom dhe është tre vjeç e gjysëm. Në familjen time bëjnë pjesë edhe dy gjyshet, Olga dhe Sofia, si dhe gjyshi im. Ai quhet Sergej dhe është apostul.



Ne banojmë në qytetin më të bukur të botës, që quhet Sankt Petersburg. Emri i tij rrjedh nga emri i apostullit Simon Pjetri. Qyteti ynë cilësohet shpesh si kryeqyteti verior i Rusisë. Këtu ka shumë kanale dhe lumej.

Unë shkoj në një shkollë të veçantë. Atje mësojnë fëmijë me veçanti psikologjike. Unë e dua, e pëlqej shkollën time dhe shkoj çdo ditë me kënaqësi atje. Atje mësojmë shumë lëndë: ruisht, letërsi, matematik, gjeografi dhe madje edhe mësim në kompjuter. Bëjmë edhe mësim për punëdore, lënda ime më e preferuar. Ne mësojmë të qepim me maqinë qepëse. Unë kam mësuar të qep shumë mirë, dhe vitin që shkoi kam prerë dhe qepur një këmishë nate si dhe një përparëse guzhine. Klasa ime rri gjithnjë bashkë me njëri-tjetrin. mbas mësimi unë ndjek aktivitete interesante jashtë shkollore në qendrën rehabilituese. Atje ushroj sportin dhe marr mësim për sistemin tim motorik.





Unë i pëlqej shumë kafshët, veçanërisht zogjtë. Më jep gëzim të madh kur i vështroj dhe kur kujdesem për ta. Kemi edhe një kafshë shtëpiake, macen Mussja. Jeton me ne qysh prej dhjetë vjetësh. Mussja është shumë e qetë dhe e përlur. Ne të gjithë e duam shumë atë.

Në verë shkojmë të gjithë si familje për të peshkuar.

Ose shëtisim me biçikleta në parkun Pawlowski. Me kënaqësi ecim rrotull qytetit dhe qetësohemi të gjithë së bashku me një piknik.

Para pak kohësh mora pjesë në një shërbesë të veçantë fetare: Në kishën tonë shërbeu apostuli kryesor Jean-Luc Schneider. Për këtë shërbesë ai u shoqërua nga apostuj nga Gjermania dhe Zvicra. Atmosfera në kishë qe shumë festive. Bëra një fotografi për kujtim: Gjyshja, gjyshi, apostuli kryesor, apostuli i distriktit Wolfgang Nadolny, mami im dhe unë.

Unë vizitoj çdo të dielë shkollën e së dielës dhe ndjehem shumë mirë atje. Pak para Vitit të Ri, ne nxënësit e shkollës të së dielës, festojmë së bashku me prindërit dhe vëllezërit e administratës.








Photo: Oliver Rütten



# Teoria dhe jeta – Të veprosh sipas Shkrimit

Predikimi, kujdesi shpirtëror dhe funksioni udhëheqës: Të treja ndjekin një udhëzim. Apostuli kryesor e shpjegon këtë duke përdorur shembullin e postit të apostujve. Por ata nuk janë të vetmit që e bëjnë këtë, që veprojnë kështu se. Çfarë thotë Bibla - dhe çfarë jo.

Kur emërohen, Perëndia u jep apostujve fuqinë e autoritetin që përmban në brendësi posti i apostujve, në mënyrë që ata të përmbushin mandatin, detyrën apostolike. Fuqia e postit u mundëson apostujve të kontribuojnë në shpëtimin e njerëzve, duke vepruar në emër të transmetuesit, dërguesit të tyre Jezu Krishtit. Kur ata emërojnë detyra, poste të tjera, apostujt u besojnë atyre një pjesë nga autoriteti i tyre.

## Predikimi bazuar në Bibël

Shërbimi apostolik përfshin predikimin e Ungjillit (Rom 1,1). Apostujt e parë shpallën atë që ata "dëgjuan dhe panë" nga Jezusi (1 Gjoni 1,1). Pali dha dëshminë e takimit të tij me të Ringjallurin dhe ai gjithashtu u mësonte atë që ai "pa dhe dëgjoi" nga ai (Vep e apost 22,14, 15).

Predikimi i apostujve të sotëm bazohet në Shkrimin e Shenjtë, veçanërisht në Testamentin e Ri. Për të theksuar rëndësinë e Ungjillit kundrejt ligjeve të Moisiut, Pali e vendos Shpirtin përballë shkronjave (2 Korint 3,6). Sidoqoftë, do të ishte krejtësisht e papërshtatshme të konkludohet nga ky varg biblik që një apostul mund të vendosë autoritetin e tij mbi Shkrimin për shkak të pushtetit të tij. Predikimi i apostujve dhe i gjithë vëllezërve të tjerë të administratës duhet të jetë gjithmonë në përputhje me Shkrimin!

Si «administratorë të mistereve të Perëndisë» (1 Korint 4,1), apostujt e tanishëm kanë autoritetin dhe aftësinë të interpretojnë Biblën me ndihmën e Frymës së Shenjtë. Drejtuar nga Fryma e Shenjtë, posti i apostujve u thekson rëndësinë e Biblës atyre që besojnë sot dhe u mëson atyre se si duhet të zbatohet Ungjilli (Mateu 28,20).

Duke e parë tekstin biblik me sytë e të sotmes, për ta bërë atë të zbatueshëm për ditët e sotme, predikimi i apostujve forcon besimin e njerëzve, forcon besimin e tyre te Zoti dhe thëllon njohuritë e tyre (për shembull, në lidhje me shpëtimin në jetën e përtejme).

## Rregullat e interpretimit

Më duket e rëndësishme të kujtoj këtu disa rregulla që duhen ndjekur kur interpretoj një tekst biblik:

- Jezu Krishti ka treguar që Testamenti i Vjetër njofton ardhjen e tij dhe veprat, punën e tij (Gjoni,39; Luka 24,27). Apostujve u kërkohet të interpretojnë Testamentin e Vjetër bazuar në Jezu Krishtin, Birin e Perëndisë. Nga pikëpamja e besimit tonë, përmbajtja e shkrimeve të Testamentit të Vjetër është e rëndësishme vetëm kur i korrespond Ungjillit, siç dëshmohet në Testamentin e Ri (Katekizmi i Kishës Apostolike të Re, Artikulli 1.2.5.2).
- Çdo tekst biblik duhet të lexohet duke pasqyruar kontekstin e tij. Interpretimi i tij duhet të jetë gjithmonë në përputhje me thëniet themelore të Ungjillit.
- Mrekullitë dhe shëmbëlltyrat e Jezusit që ai u dha atyre nuk duhet të interpretohen me tepri. Në Luka 17, Zoti flet për dy njerëz që janë në të njëjtën situatë, njëri do pranohet, tjetri jo. Ne nuk mund të nxjerrim përqindjen e atyre që janë të shpëtuar. Në shëmbëlltyrën e groshëve (parave) të besuara (Luka 19), fakti që një shërbëtor është vendosur mbi dhjetë dhe tjetri mbi pesë qytete nuk do të thotë se natyra e shpëtimit tonë që na jep Zoti varet nga shkalla e punës sonë.
- Nuk duhet harruar kurrë se të gjitha përkthimet e Biblës

janë interpretime të teksteve origjinale. Termat si "posti", "shërbimi" ose "kisha" u përkthyen ndryshe, në varësi të gjuhës dhe imagjinatës teologjike të përkthyesit. Në thelb, ne gjithmonë duhet të marrim parasysh tekstin original, nëse duam të arrijmë në një interpretim kuptimplotë.

- Ungjijtë, Veprat dhe Letrat e apostujve u shkruan në periudha të ndryshme dhe pasqyrojnë situatën në kohën e shkrimit. Kështu letrat e ndryshme, të cilat u drejtohen bashkësive ndryshojnë rrënjësisht nga përbërja dhe struktura e tyre. Bashkësitë e mëvonshme të krishtera ishin shumë më ndryshe nga bashkësitë e para, të hershme.
- Më në fund - dhe mbi të gjitha - është detyrë e apostujve të predikojnë dhe shpjegojnë thëniet e Biblës që janë vendimtare për shpëtimin e njerëzve. Ajo që është e rëndësishme është gjithçka që lidhet me besimin në Jezun Krishtin, jetën e tij dhe punën e tij. Të merresh me pjesët e tjera biblike, pra me tema të tjera, mund të jetë me interes, por ato nuk mund të vendosen kurrë në të njëjtin nivel me mesazhin qendror të Ungjillit.

## Mos tregoni asgjë përveç Jezusit

Shërbimi apostolik përfshin edhe një aspekt tjetër: Apostujt duhet të jenë dëshmitarë të Jezun Krishtit. Zoti i tha Palit: "Për këtë t'u shfaq ty, që të të zgjedh si shërbëtor dhe si dëshmitar për atë që ti ke parë deri tani në mua dhe për atë që unë ende dua të të tregoj" (Vep e apost 26,16).

Edhe apostujt e tanishëm janë thirrur gjithashtu të jenë dëshmitarë të Krishtit. Apostulati duhet gjithashtu ta bëjë

të qartë vullnetin e Jezun Krishtit në bazë të atyre gjërave që ai bën sot dhe të nxjerrë përfundimet e duhura për Kishën.

Ja disa shembuj rreth kësaj

- Jezusi, përmes apostujve të tij, bën jashtëzakonisht mrekulli - ai pret që ata të përqëndrohen kryesisht në shpëtimin e njerëzve.
- Puna e Zotit ka evoluar në mënyrë mbresëlënëse në shumë vende të ndryshme - për të jetuar besimin e tyre, të krishterët apostolikë të rinj nuk kanë pse të mbesin besnikë ndaj kulturës së tyre, por duhet të përshtaten me stilin e jetës së atyre që u sollën, që u dhanë atyre dëshmi.
- Jezun Krishtin e bëri të qartë se askush nuk mund të përcaktojë kohën e kthimit të tij. Ata që duan të përcaktojnë kthimin e Krishtit në çfarëdo mënyre, do të zhgënjehen nga Zoti - nuk është puna e apostulatis që të sigurojë një datë të kthimit të Krishtit, por të mbajë gjallë shpresën e kthimit.
- Përkundër të gjitha pritjeve, numri i shpirtrave të vulosur nuk është rritur në mënyrë të njëjtë në të gjitha pjesët e botës - kthimi i Zotit nuk varet nga numri i anëtarëve të Kishës Apostolike së Re, që jetojnë në secilin vend.

## Të drejtosh në frymën e Krishtit

Sigurisht, kisha gjithashtu ka nevojë për funksione administrimi dhe drejtimi. Zbatimi i këtyre fushave të përgjegjësive kërkon aftësi dhe njohuri të veçanta, për shembull në fushën e organizimit dhe menaxhimit. Edhe nëse këto funksione u janë besuar vëllezërve të

administratës, ato nuk lidhen në të vërtetë me autorizimin e tyre. Është e qartë se apostuli kryesor dhe apostujt e distriktit nuk veprojnë në emrin dhe autoritetin e Jezu Krishtit kur marrin vendime organizative ose financiare ... Në fund të fundit, çdo udhëheqës, në të gjitha nivelet e Kishës, duhet të marrë vendime dhe të veprojë në frymën e Krishtit!

Zoti i jep Kishës të gjitha dhuntitë që i duhen për të kryer shërbimin. Në shumicën e rasteve, ai ua jep individëve. Por gjithashtu ndodh që këto dhunti mund të zhvillohen vetëm brenda kornizës së kolegialitetit. Sot, sfidat janë aq të shumta dhe komplekse sa askush nuk mund të lejojë që në krye të Kishës të sundojë një i vetëm si monark absolut!!

## Udhëzime që nuk janë teori

Le të kthehemi te apostuli Pal. Ai kreu funksione të ndryshme në kishë. Si apostul, ai shpalli Ungjillin dhe dëshmoi për Krishtin. Por ai gjithashtu drejtoi bashkësitë për të cilat ishte përgjegjës, duke marrë parasysh mjedisin në të cilin jetonte. Letrat përmbajnë deklarata në lidhje me shpëtimin në Krishtin, të cilat bazoheshin në autoritetin e apostulit.

Por ka edhe udhëzime për menaxhimin e bashkësive, që nuk janë pjesë e mësimin, e teorisë aktuale. Ato janë rezultat i drejtpërdrejtë i kushteve të jetesës së asaj kohe dhe janë të vlefshme vetëm në lidhje me to. Për shembull, detyra e grave në Korint ishte të heshtnin (1 Korint 14,34) dhe ta ushtronin këtë (1 Timoteut 2,12) - në Cezarea, nga ana tjetër, ato kishin të drejtë të profetizojnë (Vep e apost 21,9). Ose specifkimet në lidhje me stilin e flokëve dhe veshjen e tyre (1 Timoteut 2,9)

## Kujdesi shpirtëror dhe përgatitja e tij

Më në fund, do të dëshiroja të diskutoja shkurtimisht përdorimin e Biblës në kontekstin e një vizite në shtëpia. Në shumë vende, është e zakonshme të kërkoni që vëllai i administratës të hapë biblën „rastësisht, spontanisht“ për të lexuar dhe komentuar një pjesë. Kjo traditë është mjaft e respektueshme, por nuk është pa rrezik.

Ne e dimë që një tekst biblik duhet interpretuar gjithmonë në lidhje me kontekstin. Tani kjo është vështirë të realizohet mirë, nëse është një fjalë biblike e zgjedhur në mënyrë spontane. Në këtë aspekt, fjala mund të interpretohet keq. Ndodh gjithashtu që vëllezërit dhe motrat e shohin fjalën e lexuar nga vëllai i administratës si një profeci ose një premtim hyjnor. Nga kjo nxjerrin konkluzion se Zoti do t'i dëgjojë dëshirat e tyre dhe do veprojë në një mënyrë të caktuar. Nuk janë të pakta rastet që shpresa të tilla të zhgënjehen.

Le të jemi të vetëdijshëm se nuk është detyra e vëllait të administratës të zbulojë vëllezërve dhe motrat e ardhmen e tyre! Misioni i tij është të udhëhiqet nga Fryma e Shenjtë për të forcuar vëllezërit dhe motrat në besimin e tyre dhe në besimin ndaj Zotit.

A nuk do të ishte më mirë nëse vëllai i administratës ta përgatiste vizitën e tij duke i kërkuar Zotit t'i zgjojë atij një fjalë biblike, e cila mund të shërbente si një udhëzues për kujdesin shpirtëror? Të kuptohet mirë, nuk është menduar që ai të mbajë predikim në një vizitë në familje, por të shkëmbejë disa mendime me motrat dhe vëllezërit mbi atë fjalë biblike.

Masthead

Autori: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Switzerland

Shtëpia botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Peter Johanning





Photo: Oliver Rütten

# Apostuli kryesor: Kurajo – jeta vazhdon

Mars 2020: Ndalim qarkullimi në Francë: Edhe apostuli kryesor Jean-Luc Schneider qëndron brenda në shtëpi – dhe me javë të tëra pa marrë Darkën e Shenjtë. E megjithatë nuk e humb kurajën: „Unë e di, që Zoti nuk i le vetëm fëmijët e tij, pikërisht në kohë apo në situatë të vështirë.“

„Unë e marr shumë seriozisht këtë krizë“, tha drejtuesi i kishës ndërkombëtare, në intervistën e tij, e cila u dha zyrtarisht në nak.org. „Fatkeqësisht do të ketë edhe shumë viktima të tjera. Ne marrim pjesë në dhimbjen e familjeve të të prekurve dhe lutemi për ta!“

Për shkak të kufizimeve të ndërmarra nga qeveria atij iu desh të hiqte dorë nga shumë udhëtime të planifikuara. „Në këtë moment nuk e di askush, se si do të zhvillohet më tej situata. Do të veproj në këtë situatë si të gjithë të tjerët“

„Qëndroni nëpër shtëpia dhe shfrytëzoheni sa më mirë,

sa më bukur këtë situatë“, u rekomandoi apostuli kryesor motrave dhe vëllezërve. Ai falenderon të gjithë ata që angazhohen dhe qëndrojnë pranë njëri-tjetrit. „ Eshtë vërtet bukur kur shikon se sa njerëz janë të gatshëm të ndihmojnë të tjerët në situata të tilla.“

## Të dallosh se çfarë është me të vërtetë e rëndësishme

„E di që motrave dhe vëllezërve do t’u mungojë marrja e Darkës së Shenjtë deri në përfundimin e kësaj Pandemie“, thekson drejtuesi i kishës. „Marr pjesë në shqetësimin e

tyre, por nuk ka një zgjidhje, e cila mund ta zevëndësojë plotësisht atë“, tha ai në intervistë me zëdhënësin e kishës Peter Johanning.

Janë diskutuar qasje të ndryshme – si dërgimi i hostjeve të shenjtëruara më parë ose marrja nga një përfaqësues i vëllezërve të administrates si në rastin e shërbesave për shpirtrat e larguar tashmë nga kjo jetë. Megjithatë: „Ne duhet të hamë trupin e Jezusit dhe të pimë gjakun e tij, duke e marrë hostien në mënyrë dinjitoze, të shenjtëruar dhe të dhënë nga një vëlla administrate me detyrë priftërore“, i referohet ai artikullit të shtatë të besimit.

„Ne nuk e dimë përse e lejon Zoti një situatë të tillë“, tha apostuli kryesor. „Por jam i sigurt se kjo periudhë e mungesës shpirtërore do të na ndihmojë të njohim më shumë se kurrë se sa të rëndësishëm janë për ne shërbesat fetare, vëllezërit e administratës dhe Darka e Shenjtë!“

## Të mësosh nga motrat e vëllezërit

„Këto janë ditët kur ne mund të mësojmë nga vëllezërit dhe motrat tona që kanë përjetuar vuajtje të mëdha më parë“ ai kujton këtu viktimat e tërmetit indonezian, të cilët nuk mund të mbroheshin, refugjatët afrikanë që ishin të mbyllur, të kufizuar me vite të tëra, dhe viktimat e luftës Kongoleze, të cilët brenda natës kanë humbur gjithçka që kishin dhe të krishterët e Afrikës Perëndimore që vriteshin kur merrnin pjesë në shërbesat fetare.

Apostuli kryesor nuk dëshiron të minimizojë krizën e Koronës. „Por përkundrazi, thjesht të mësojmë nga këta vëllezër dhe motra: «Pse mundën të qëndrojnë të fortë ata, pavarësisht nga të gjitha sfidat? Sepse janë të rrënjosur thellë në Krishtin. Dashuria juaj për Zotin është sekreti juaj!“ Mësimi që ai nxjerr prej kësaj.“ Gjëja kryesore tani është të ruajmë marrëdhëniet tona me Krishtin!“

## Të mbahesh fort tek dashuria dhe besimi

„Por ne duam t’i besojmë Zotit në këto kohë vështirësish“, apelon drejtuesi i kishës. „Le t’i besojmë Zotit - ai gjithmonë e di, se si t’u japë atyre që e duan atë, gjënë që është thelbësore për shpëtimin e tyre!“

Dhe: „Le të qëndrojmë të vendosur në dashuri ndaj Perëndisë. Zoti gjithmonë do t’i ndihmojë ata që e duan atë në një mënyrë të veçantë. Premtimi i Zotit mbetet: Për ata që e duan Zotin, të gjitha gjërat - madje edhe kriza e koronës - shërbejnë për shpëtimin e shpirtrave të tyre.“

„Guxim“, tha apostuli kryesor Schneider, „jeta vazhdon“.

## Shërbesat fetare sfidojnë krizën e Koronës



Photo: Oliver Rütten

Nëse besimtari nuk mund të vijë në shërbesën fetare, atëherë i vjen ajo besimtarit. Kështu kujdeset Kisha Apostolike e Re për anëtarët e saj në krizën e Koronës. Por mundësitë janë shumë të ndryshme në të gjithë botën.

Shkak është kryesisht ndalimet shtetërore ndaj grumbulimeve të mëdha, por edhe masat paraprake personale. Dhe kjo ka të bëjë me zvogëlimin e numrit të kontakteve personale për të mbrojtur njerëzit. Kjo ka për qëllim të ngadalësojë përhapjen e pandemisë së koronës dhe të zvogëlojë mbingarkesën e kujdesit mjekësor.

Katër kishat gjermane kanë krijuar kanale të tyre në YouTube me qëllim që të zgjerojnë burimet e tyre për transmetimin e shërbesave fetare. Amerika e Jugut ka portalin e saj të transmetimit. Dhe Afrika e Jugut madje mundi të përdorë kanalin e vet televiziv „NAC TV“, i cili gjithashtu ofron shërbesat fetare të së mërkurës. Në krye të kësaj çështjeje janë Amerikanët e Veriut, të cilët tashmë kanë një përvojë në transmetimin e shërbesave fetare. Kanadaja dhe Sh.B.A-ja jo vetëm që transmetojnë në mënyrë preçize, por gjithashtu kanë një numër të madh të rekordeve në dispozicion për rikthim, rishikim gjatë gjithë javës.

Kisha e Qarkut të Republikës Demokratike Juglindore të Kongos merr një rrugë krejtësisht tjetër. Një kanal i veçantë në YouTube gjithashtu është vendosur atje. Por shumica e 1.8 milion vëllezërve dhe motrave nuk kanë fare ose nuk kanë qasje të përshtatshme në internet. Aq sa u lejohet, vëllezërit e administratës shkojnë nga shtëpia në shtëpi, bëjnë një shërbesë të shkurtër fetare dhe festojnë Darkën e Shenjtë. Për shkak se bashkësitë janë tepër të mëdha, ata duhet të jenë në lëvizje jo vetëm të dielave, por gjatë gjithë javës, shkruan Apostuli i distriktit Tshitshi Tshisekedi. Për t’i mbështetur ata, ai ka riaktivizuar të gjithë vëllezërit që tashmë kanë dalë në pension.



New Apostolic Church  
International

